DOKUMENT MBI QËNDRIMIN PËR FINANCIMIN E LËVIZJEVE FEMINISTE

ME RASTIN E MBAJTJES SË
FORUMIT PËR BARAZI TË GJENERATAVE

Ky dokument mbi qëndrimin është përpiluar dhe nënshkruar nga koalicioni i 145 organizatave të shoqërisë civile për të drejtat e grave (OShCG) në kontekstin e Forumit të ardhshëm për Barazinë e Gjeneratave (FBGj). FBGj përfshin Koalicione të Veprimit që kërkojnë "rezultate të prekshme" sa i përket "financimit" dhe "të dhënave gjinore dhe llogaridhënies", duke përfshirë këtu koalicionet posaçërisht mbi "Drejtësinë ekonomike dhe të drejtat" dhe "Lëvizjet feministe dhe udhëheqjen". Sipas faqes së internetit të FBGJ , "Secili Koalicion i Veprimit do të propozojë një sërë veprimesh konkrete, ambicioze dhe të menjëhershme brenda periudhës 2020-2025 për të dhënë kontribut të prekshëm në barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut të grave dhe të vajzave. Ata do të sigurojnë financim për këtë agjendë, për të adresuar boshllëqet sistematike në burime që kanë penguar deri më tani ndikimin/kontributin." Ky dokument propozon zotimet që të poshtë nënshkruarit do të donin të shihnin nga agjencitë e KB-së, Bashkimi Evropian (EU) dhe financuesit shtetërorë, në konsultim të ngushtë me OShCG-të dhe lëvizjet feministe.

1. TË VENDOSEN SYNIMET E QARTA PËR TË PËRMBUSHUR ZOTIMET

Sfida: Pabarazitë e dukshme gjinore vazhdojnë të ekzistojnë në nivel global dhe ka të ngjarë të jenë përkeqësuar mes pandemisë COVID-19. Si pjesë e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), Agjendës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (GPS) dhe planeve të ndryshme të veprimit gjinor, KB, BE-ja dhe disa shtete janë zotuar të përfshijnë dhe mbështesin OShCG-të si nxitësit kryesorë të ndryshimit. OShCG-të, në të vërtetë, kanë qenë në krye të përpjekjeve për të transformuar normat dhe strukturat gjinore, për të ofruar shërbime thelbësore dhe për të përmirësuar përgjigjet institucionale ndaj pabarazive. Mes ndryshimeve të qeverisë, jostabilitetit dhe krizave, ato kanë mbetur avokuese të qëndrueshme. Ato kanë qenë faktor kyç në vendosjen e paqes mes konfliktit. Megjithatë, dëshmitë tregojnë qartë se fondet nuk po shpërndahen në përputhje me zotimet e lartpërmendura të politikave. Vetëm afërsisht 4% e ndihmës zyrtare për zhvillim (ODA), në mënyrë të qartë, financon barazinë gjinore.[1]

Veprimi i propozuar: Të gjithë financuesit duhet të zotohen:

- *Të kërkojnë* buxhetim të përgjegjshëm gjinor, bazuar në analizën gjinore, për të gjitha programet. BE-ja dhe shtetet mund të përdorin kushtëzime që lidhen me financimin e tyre, duke kërkuar nga organizatat multilaterale, OJQN-të, kompanitë dhe qeveritë të përdorin buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe të ndajnë e të planifikojnë një pjesë të financimit të tyre për të drejtat e grave, përkatësisht për OShCG-të.
- *Të kërkojnë* përcjelljen/ e saktë të shpenzimeve aktuale për barazinë gjinore, përkatësisht të OShCG-ve, përfshirë edhe për veprimet që kanë të bëjnë me integrimin e perspektivës gjinore.

[1] Rrjeti OECD DAC për barazi gjinore (GenderNet), "Ndihma e fokusuar në barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave ", 2020.

2. TË NXITEN PËRPJEKJET PËR TË RISHIKUAR SHËNUESIN GJINOR TË OBZHE-S DHE TË KËRKOHET PËRDORIMI I TIJ I PËRMIRËSUAR

Sfida: E gjithë ndihma zyrtare për zhvillim (ODA) duhet të përdorë Shënuesin Gjinor to OBZHE-së, që kërkon të shënohet çdo veprim, bazuar në analizën gjinore. Aktualisht, hulumtimi[2] ka treguar mosshënimin e konsiderueshëm ose keq-shënimin e fondeve. Vetëm një pjesë e veprimeve që përfshijnë shënuesin gjinor 1 aktualisht financojnë barazinë gjinore, gjë që kontribuon në mbiraportimin e pasaktë të shpenzimeve aktuale për barazinë gjinore. Aktualisht, Shënuesi Gjinor i OBZHE-së nuk mat kontributet financiare në nivelet e rezultatit ose të aktivitetit. Buxhetimi i duhur i përgjegjshëm gjinor, sipas UN SDG Treguesit OZHQ të KB 5c1 dhe shënjimi adekuat sipas udhëzimit të Shënuesit e Politikës së Barazisë Gjinore të OBZHE-së do të kërkonte analiza të përshtatshme gjinore për të shënuar me saktësi kontributet e projekteve në barazinë gjinore. Nuk ekzistojnë mekanizma ose sisteme të qarta për të përcjellë fondet për OShCG dhe lëvizjet feministe.

Veprimi i propozuar: Të gjithë financuesit: në përputhje me praktikat më të mira në buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe udhëzimet për shënuesin gjinor të OBZHE-së, zotohen:

- *Të kërkojnë* që analiza gjinore të përfshihet në të gjitha dokumentet e projektit drejt informimit të duhur të modelit të veprimit.
- *Të kërkojnë* që shpenzimet të alokohen qartë për të përmbushur nevojat e identifikuara përmes analizës.
- *Të kërkojnë* raportimin e shpenzimeve aktuale në të gjitha nivelet e logjikës së ndërhyrjes; të mos pranojë që objektivat të llogariten si kontribute për barazinë gjinore kur vetëm një pjesë e fondeve të objektivit mbështet avancimin e barazisë gjinore.
- *Të vendosin* sisteme për përcjelljen e shpenzimeve aktuale për barazinë gjinore dhe OSHCD-ve si aktorët kryesorë, përkatësisht nxitësit e ndryshimeve transformuese.
- Për OBZHE: *Shtoni* dy nivele shtesë në Shënuesin Gjinor të OBZHE-së për të matur shpenzimet në nivelet e rezultatit dhe aktiviteteve, sipas buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.

3. TË SHQYRTOHEN MODALITETET E KONTRAKTIMIT DHE TË BËHEN PËRPJEKJE PËR TË KONTRAKTUAR OSHCG-TË

Sfida: Qasja mbizotëruese e kontraktimit të ekspertëve ose kompanive individuale, sesa të OSHCG-ve, për përpjekjet në lidhje me avancimin e barazisë gjinore dhe të drejtat e grave shpërqendron burimet financiare dhe njerëzore nga OSHCG dhe lëvizjet feministe. Kontraktimi i individëve në vend të OSHCG-ve minon njohjen e ekspertizës dhe rolit të organizatave në kontributin e tyre ndaj ndryshimeve. Procesi aktual i vetingut i KB që është i ndërlikuar dhe që merr shumë kohë përjashton shumë OShCG dhe zyrat e agjencisë së KB duket se i shmangin këto procese se konsumojnë shumë burime, duke preferuar kontratat e shërbimit. Kontratat afatshkurtra dhe ato të bazuara në projekte e bëjnë të vështirë organizimin rreth qëllimeve strategjike afatgjata.

Veprimi i propozuar: Financuesit, zotohen se do të:

- *Rishikojnë* modalitetet aktuale të financimit, veçanërisht ato të përdorura globalisht nga agjencitë e KB, duke i përshtatur për të mundësuar kontraktimin më të lehtë të OShCG-ve si partnere afatgjate në ndryshim .
- *Inkurajojnë në mënyrë aktive* kontraktimin e OShCG-ve që kanë ekspertizë, e jo të ekspertëve individualë, drejt ndërtimit të lëvizjes (në kontekste ku OShCG-të mund të

[2] Shih, për shembull: *Ku janë paratë për të drejtat e grave?*, 2020.

marrin financim të huaj në mënyrë të sigurt). Pas shqyrtimit të duhur, do të vendosin partneritete afatgjata të financimit me OShCG-të si partnerë të barabartë.

- *Vendosin më shumë modalitete dhe më të ndryshme të financimit*, që përfshijnë financime shumëvjeçare dhe thelbësore, e që mund të kontribuojnë në veprime më strategjike afatgjata, fleksibilitet mes situatës jostabile politike dhe konfliktit, kapacitete të ngritura dhe qëndrueshmërinë e OShCG-ve dhe lëvizjeve.

4. KB: TË HARTOJË DHE TË ZBATOJË POLITIKËN GLOBALE E MOS-KONKURRENCËS

Sfida: Agjencitë e KB shpesh, me dashje ose pa dashje, konkurrojnë me OShCG-të për fonde ose marrin përsipër punën që e bëjnë OShCG-të. KB ka konsiderueshëm më shumë burime sesa OShCG-të, gjë që e bën më të lehtë për agjencitë e KB të zotojnë burime për mbledhjen e fondeve. Për më tepër, zotimet e shteteve dhe të BE-së ndaj KB-së nënkuptojnë që agjencitë e KB-ve nuk i nënshtrohen të njëjtave procese të prokurimit ata mund të negociojnë më lehtë financimin e drejtpërdrejtë. Kjo mund të kontribuojë në konkurrencën e padrejtë në marrjen e burimeve.

Veprimi i propozuar: KB-ja duhet të zotohet për të krijuar një politikë "jo-konkurruese" për fonde me OShCG-të në nivelin global dhe për të siguruar që zyrat e vendit dhe ato rajonale ta zbatojnë atë.

5. AGJENCITË E KB: TË KËRKOJNË VLERËSIME TË PAVARURA TË NEVOJËS

Sfida: Në disa kontekste, agjencitë e KB mund të luajnë rol kryesor në bindjen e qeverive për të ndryshuar qasjen e tyre, ndërsa në kontekste të tjera ka rrjete të forta të grave, dhe agjencitë e KB duhet të kenë rol tjetër, siç është mbështetja e monitorimit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut. Zyrat e vendit mund të mos jenë gjithmonë të nevojshme. Në disa raste, ato mbivendosen dhe/ose shpërqendrojnë mbështetjen nga OShCG-të dhe lëvizjet feministe lokale.

Veprimi i propozuar: KB dhe financuesit e saj: të zotohen për kryerjen e vlerësimeve të pavarura periodike (p.sh., 5 vjeçare) për të përcaktuar vlerën e shtuar të zyrave të vendit të agjencisë së KB në kontekste të veçanta. Nëse ekzistojnë organizata lokale dhe/ose rrjete të forta për të drejtat e grave, t'i përkrahini ato në vend të zyrave të vendit që janë relativisht më të shtrenjta, drejt efektivitetit, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së OShCG-ve dhe lëvizjeve feministe.

6. TË PËRMIRËSOHET EFIKASITETI I BURIMEVE EKZISTUESE

Sfida: Strategjitë, shabllonet, afatet kohore dhe procedurat e prokurimit të ndryshme të financuesve krijojnë ngarkesë të konsiderueshme administrative për OShCG-të, duke iu marrë kohën nga aktivizmi i tyre. Raportimi tremujor, siç është përdorur nga sistemi i KB, përfshin ngarkesë të konsiderueshme administrative për stafin dhe aktivistët e ngjashëm. Koordinimi i dobët në planifikimin e strategjive dhe veprimeve të shoqëruara me fleksibilitetin e financuesve kontribuon në mbivendosje, përdorim joefikas të burimeve dhe qasje jo shumë strategjike për ndryshimin transformues.

Veprimi i propozuar: Financuesit: Të zotohen për një koordinim më proaktiv *mes* financuesve dhe aktivistëve për strategji të përbashkëta, përpjekje të përbashkëta dhe financim kolektiv drejt qëllimeve të përbashkëta. Për shembull, të kërkojnë vetëm një raport për disa financues, duke zvogëluar kështu barrën administrative dhe burimet e kërkuara nga financuesit dhe aktivistët e ngjashëm. Të zotohen se do të rishikojnë procedurat e llogaridhënies për të hartuar modalitete të tjera për të siguruar llogaridhënie, bazuar në

rezultatet e arritura. Agjencitë e KB: Të zotohen për t'i dhënë fund kërkesave për raportimin tremujor.

7. TË PËRFSHIHEN OSHCG-TË NË PLANIFIKIMIN E PROGRAMIT DHE DIALOGUN POLITIK

Sfida: Ndonjëherë agjencitë e KB, organizatat ndërkombëtare dhe/ ose aktorët e zhvillimit nuk ftojnë ose përfshijnë OShCG-të që kanë ekspertizë të gjerë për çështje të caktuara, për të qenë pjesë e dialogut politik mbi këto çështje (p.sh., dhuna me bazë gjinore, buxhetimi i përgjegjshëm gjinor, statistikat gjinore). Përkundër ekspertizës së tyre, puna e OShCG-ve ndonjëherë relativizohet dhe degradohet. Shpesh OShCG-të madje nuk konsultohen gjatë proceseve të planifikimit të programeve të reja që synojnë të avancimin e barazisë gjinore. Kjo kontribuon në planifikimin e dobët, duplikimin e përpjekjeve dhe përdorimin joefikas të burimeve.

Veprimi i propozuar: Të gjithë aktorët e zhvillimit: Të sigurojnë që OShCG konsultohen gjatë proceseve të planifikimit të programeve të reja, posaçërisht për ato që fokusohen në fushat ku ato kanë ekspertizë. Të sigurojnë që OShCG-të lokale me ekspertizë konsultohen dhe përfshihen në dialog politik me homologët e qeverisë, duke përfshirë ekspertizën e OShCG-ve, ndërtimin e marrëdhënieve mes qeverisë-shoqërisë civile dhe sigurimin e mbështetjes dhe dukshmërisë së rëndësishme politike të OShCG-ve.

8. TË NJIHET DHE VLERËSOHET PUNA E OSHCG-VE

Sfida: Në raportet në nivelet e vendit dhe ato ndërkombëtare, në disa raste agjencitë e KB nuk kanë arritur të njohin publikisht kontributet e OSHCG-VE për arritjet e bëra. Në rastet më të këqija, agjencitë e KB kanë marrë merita për punën që e kanë bërë OShCG-të. Në rastet e tjera, raportet nga agjencitë e KB përmendin vetëm "OShC-të" , pa i njohur siç duhet emrat e OShCG-ve që kanë punuar shumë për të sjellë ndryshime shoqërore.

Veprimi i propozuar: Agjencitë e KB: të zotohen se do të njohin dhe do të iu japin merita OShCG-ve, me emra. Kjo mund të kontribuojë, në mënyrë të konsiderueshme ,në vlerësimin e ekspertizës së OShCG-ve, e cila mund të përkthehet në mbështetje politike, legjitimim të mëtejshëm të punës së tyre në sytë e qytetarëve dhe qeverive kombëtare, si dhe në burime. Kjo do të kontribuonte në zbatimin e rezolutave të KB, drejt qëndrueshmërisë së OShCG-ve dhe lëvizjeve përmes mbështetjes së përmirësuar lokale.

ZOTIMI YNË

Ne, të poshtë nënshkruarit, zotohemi se do të vazhdojmë avokimin tonë të bazuar në dëshmi për këto çështje dhe të mbetemi të pranishëm për të siguruar ekspertizën tonë në mbështetje të veprimeve të propozuara këtu.

1. Aleanca e organizatave për persona me aftësi të kufizuara, Moldavia (53 organizata, lista e plotë në http://aopd.md/membrii-aopd/)
54. Komiteti e Qytetarëve të Helsinkit, Banja Lluka, Bosnjë dhe Hercegovinë
55. Community Building Mitrovicë, Kosovë
56. Fokusi i Fondacionit për Zhvillimin Lokal dhe Demokracinë, Velezh, Maqedonia Veriore
57. Fondacioni Gratë e Bashkuara, Banja Lluka, Bosnjë dhe Hercegovinë
58. Fondacioni Ipko, Kosovë
59. Gazetar për të drejtat e njeriut, Maqedonia Veriore
60. Gratë për Paqe - Leskovac (Žene za mir – Leskovac), Serbi
61. Iniciativa Civile për Mundësi të Barabarta "SEMPER", Manastir, Maqedonia Veriore

62. Iniciativa e Pavarur e të Verbërve, Kosovë
63. Iniciativa Qytetare e Grave "KLEA" – Manastir, Maqedonia Veriore
64. Keystone Moldavia
65. Koalicioni rural, Kiçevë, Maqedonia Veriore
66. Koalicioni "Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të margjinalizuara" – MARGINS, Maqedonia Veriore
67. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Maqedonia Veriore
68. Komiteti për të Drejtat e Njeriut, Vranjë (Odbor za ljudska prava Vranje), Serbi
69. Linja e këshillimit për gra dhe vajza, Shqipëri
70. Linja e Ndihmës SOS për Gratë dhe Fëmijët Viktima të Dhunës, Vlasotince (SOS telefon za žene i decu žrtve nasilja, Vlasotince), Serbi
71. Medica Kosova, Kosovë
72. Nisma qytetare e grave, GIZ Sveti Nikole, Maqedonia Veriore
73. Oaza e sigurisë Kragujevac (Oaza sigurnosti Kragujevac), Serbi
74. OJQ Drugëza, Skenderaj, Kosovë
75. OJQ për Avokim dhe Riintegrim te Viktimave te Dhunës, Kosovë
76. Organizata e Grave (Organziacija na zheni), Manastir, Maqedonia Veriore
77. Organizata e Grave të Komunës së Sveti Nikole, Sveti Nikole, Maqedonia Veriore
78. Organizata Humanitare Arsimore Shtip, Maqedonia Veriore
79. Platforma për barazinë gjinore, Moldavia (36 anëtarë, lista e plot në: https://egalitatedegen.md/membri)
115. Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Shqipëri
116. Qendra alternative e vajzave, Serbi
117. Qendra e Grave - Uzice (Ženski centar - Užice), Serbi
118. Qendra e Grave Autonome (Autonomski ženski Centar, Beograd), Serbi
119. Qendra Gjinore, Moldavia
120. Qendra për Hulumtime dhe Politikbërje, Shkup, Maqedonia Veriore
121. Qendra për të Drejtat e Grave Etika, Gostivar, Maqedonia Veriore
122. Qendra për të Drejtat e Grave, Mali i Zi
123. Qendra Rome për Gratë dhe Fëmijët, Daje, Serbia
124. Reactor – Research in Action, Maqedonia Veriore
125. Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri, Shqipëri
126. Rrjeti i Grave të Kosovës, Kosovë
127. Shoqata "Unë Gruaja", Shqipëri
128. Shoqata ASTRA – Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Beograd (Astra – akcija protiv trgovine ljudima – Beograd), Serbi
129. Shoqata e Grave Femina, Smederevska Palanka (Udruženje žena Femina, Smederevska Palanka), Serbi
130. Shoqata e Grave Impulse Tutin (Impuls Tutin) (Serbi)
131. Shoqata e Grave Rome (ShGR) "E ARDHME MË E MIRË", Bosnje-Hercegovinë
132. Shoqata e Grave të Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut, Kosovë
133. Shoqata e Grave, Krushevac (Udruženje žena Peščanik, Kruševac), Serbi
134. Shoqata për Paqe dhe Siguri Gjinore, Shqipëri
135. Shoqata e qytetarëve për zhvillimin rural RAJ, Rosoman, Maqedonia Veriore
136. Shoqata e qytetarëve Sirma, Kumanovë, Maqedonia Veriore
137. Shoqata e Viktimologjisë së Serbisë, Beograd (Viktimološko društvo Srbije, Beograd), Serbi
138. Shoqata Fenomena, Kralevë (Udruženje Fenomena Kraljevo), Serbi
139. Shoqata për Inovacione Sociale dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm RADAR, Shkup, Maqedonia Veriore
140. Shqiponjat e Dardanës, Kosovë
141. SOS Qendra e Grave, Novi Sad (SOS Ženski centar Novi Sad), Serbi

142. Svet Andjela, Mitrovicë, Kosovë
143. Vatra Qendra Psiko-Sociale, Shqipëri
144. Vizioni Agrita, Shqipëri
145. WNGO Veprimi i Grave, Mali i Zi